

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019
(Të gjitha balancat janë në lekë).

1. Informacione te pergjitheshme

“ANK” sh.p.k është themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas vendimit te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane me nr vendimi 19563 date 05.06.1998 me Kapital te rregjistruar ne shumen 493 000 000 leke dhe zoterohet nga ortaku i vetem Agim Kola me masen 100%.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2019 jane ne fushen e ndertimit te rrugeve, ujesjellesave dhe te objekteve social kulturore.

Adresa e sakte e shoqerise eshte Rruga e Kavajes, Ish parku i Autobuzave, Kulla Condor, Kulla “C” Kati 3, Tirane. Kontaktet me shoqerine ANK Shpk jane Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 068 40 22 362

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com

Struktura ne perqindje e aktivitetit te shoqerise eshte

Ndertim	94%
Prodhim dhe shitje inerte	6%

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar ‘Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare’ dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazen e parimit të kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostatuara. Ato paraqiten në monedhen vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2019 është zbatuar formati i SNK Standartet Nderkombetare të Kontabilitetit dhe ligjit Nr. 9228 dhe për rrjedhim zërat e pasqyrave financiare të periudhës krahasuese 2019 janë klasifikuar në pershtatje me formatin e ri, ndryshime të cilat shpjegohen në shenimet në vazhdim.

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:

Adresa: Rruga e Kavajes, Ish parku i Autobuzave, Kullat Condor, Kulla “C” Kati 3, Tirane.

Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 069 20 32 353, 068 20 45 054

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com



Njohja e te ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atehere kur ato sigurohen prej të treta dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 30.12.2018 janë : 1 euro=121.77 leke , 1 USD= 108.64 leke .

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2019 është 15 %.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me



koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivët e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivët afatgjatë materiale (A.A.M-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës së vlerësimit të mbetur për makineri e pajisje si dhe për tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura për amortizimin është 20 % të vlerësimit të mbetur të aktivitetit, norme të cilat janë brenda kufijve që lejohen nga ligjvendimi fiskal.

Gjendjet e inventarëve

Vlerësimi në hyrje të inventarëve bëhet me çmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

1. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetëve monetare në bankë dhe arke, në lekë dhe valute në datën 31 Dhjetor 2018 janë si më poshtë:

Gjendja e mjetëve monetare në llogaritë bankare në datën 31.12.2018 është në mënyrë të poshtme:

Nr.	Emertimi	Gjendja dt.31.12.2019	
		Debi	Monedha baze(Leke)
1	Banka Kombëtare Tregëtare në LEKE	30.358.887,04	30.358.887,04
2	Banka Kombëtare Tregëtare Kredia në LEKE	1.095.457,46	1.095.457,46
3	Credins Banke në LEK	14.995.337,46	14.995.337,46
4	Raiffeisen Banke në LEK	6.645.951,14	6.645.951,14
5	Credins Depozite në Lekë	123.500.000	123.500.000
A	Shuma e llogarive në Lekë		176.595.633
1	Banka Kombëtare Tregëtare ngurtësime në euro	1.393.756,32	169.717.707,00
2	Banka Kombëtare Tregëtare në EURO	1.874.049,6	228.203.019,70
3	Credins Bank Euro	8.114,33	988.081,90
4	Raiffeisen Banke në Euro	541,17	65.898,20

Adresa: Rruga e Kavajës, Ish parku i Autobuzave, Kullat Condor, Kulla "C" Kati 3, Tiranë.

Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 069 20 32 353, 068 20 45 054

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com



1	Alpha Bank USD	0
2	Banka Kombetare Tregetare ne USD	0
3	Credins Bank USD	0
B	Shuma e llogarive	575.570.340,2

Gjendja e mjeteve monetare ne arke ne daten 31.12.2019 eshte si me poshte:

Gjendja e arkës ne dt. 31.12.2019

Kod i	Pershkrimi	Gjendja 31.12.2019	
		Gjendje Leke	Monedha baze(Leke)
ALL.	Arka ne leke	230.864	230.864
	Shuma		230.864

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura ne monedhe te huaj, jane perkthyer ne leke duke perdorur kursin e kembimit te fundit te vitit 2019, te Bankes se Shqiperise.

2. Aktive te tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 deklarohen si vijon:

	Viti 2019	Viti 2018
3 Aktive te tjera financiare afatshkurtra	872.637.490	885.244.299
> Kliente per mallra, produkte e sherbime	864.205.111	863.005.608
> Debitore, Kreditore te tjere	5.000.000	7.500.000
> Tatim mbi fitimin	0	2.131.882
> Tvsh	0	0
> Te drejta e detyrime ndaj ortakeve	0	0
> Tatim page per tu kthyer	0	0

Adresa: Rruga e Kavajes, Ish parku i Autobuzave, Kullat Condor, Kulla "C" Kati 3, Tirane

Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 069 20 32 353, 068 20 45 054

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com



Ne “Kliente per mallra, produkte e sherbime” jane pasqyruar situacionet e ndertimit te cilat nuk jane likujduar nga investitoret.

Bashkangjitur eshte edhe lista e detajuar per çdo klient me shumat perkatese te cilat deri me 31.12.2019 nuk jane arketuar.

3. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te vitit ushtrimor paraqiten:

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
4 Inventari	88.931.906	18.142.162
> <i>Lendet e para, karburante</i>	2.431.906	17.779.621
> <i>Inventari lmet</i>	0.00	0.00
> <i>Prodhim ne process</i>	0.00	0.00
> <i>Produkte te gatshme</i>	86.500.000	0.00
> <i>Mallra per rishitje</i>	0.00	0.00
> <i>Parapagesa per furnizime</i>	0	362.541

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike e kryer ne fund te ushtrimit 2019.

Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershem.

Si politike kontabel ne percaktimin e kostos se inventarit eshte perdorur metoda “mesatares se ponderuar”.

Shuma e inventarit te paraqitur ne “Lende e pare dhe karburante” perfaqeson stokun e materialeve dhe karburanteve, te vleresuara me kostot mesatare te blerjes.

Bashkangjitur eshte edhe lista e detajuar per “Lendet e para” me sasite, çmimet e blerjeve dhe shumat perkatese deri me 31.12.2019.

Organet drejtuese te shoqerise mendojne se vlera e paraqitur eshte vlera me e ulet mes kostos se marrjes dhe vleres neto te realizueshme dhe nuk eshte nevoja per zhvleresime te tij

Shuma e inventarit te paraqitur ne “Produkt i gatshem ” perfaqeson stokun e inerteve te cilat shoqeria i ka prodhuar te realizimin e kontrates



koncesionare/PPP “Projektim Ndertim dhe mirembajtjen e segmentit rrugor Milot – Balldre “, te vleresuara me kostot mesatare te blerjes.

4. Aktivitet Afatgjata Materiale (AAM-te)

Gjendjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare me 31.12.2019 paraqitet si vijon:

	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
AKTIVET AFATGJATA	699.250.879	685.116.448
1 Investimet financiare afatgjata		
2 Aktive afatgjata material	690.250.879	685.116.448
> Toka	45.305.000	45.305.000
> Ndertesa	0	0
> Makineri dhe paisje	338.334.920	309.253.789
> Aktive tjera afat gjata materiale	19.964.230	16.866.440
> Mjete transporti	283.203.561	303.730.349
> Paisje zyre informatike	7.752.034	9.960.870
3 Ativet biologjike afatgjata	0	0
4 Aktive afatgjata jo material	0	0
5 Kapitali aksioner i pa paguar	0	0.00
6 Aktive te tjera afatgjata	0	0.00

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2019.

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne llogarite vjetore me vlefte fillestare dhe me vlefte te mbetur eshte si me poshte:

Adresa: Rruga e Kavajes, Ish parku i Autobuzave, Kullat Condor, Kulla “C” Kati 3, Tirane.

Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 069 20 32 353, 068 20 45 054

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com



Nr	Emertimi	Gjendje 1/1/2019	Shtesa	Amortizimi	Gjendje 31/12/2019
1	Toka	45,305,000	0	0	45,305,000
2	Ndertime				0
3	Makineri,paisje	309,253,789	90.931.888	61.850.758	338.334.920
4	Mjete transporti	303,730,349	40.219.282	60.746.070	283.203.561
5	Paisje informatike	9,960,870	4.638.135	1.951.258	7.752.034
6	Mobilje dhe orendi	16,866,440	6.471.078	3.373.288	19.964.230
	TOTALI	685.116.448	250.067.872	127.921.374	699.250.879

Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale. Ajo eshte llogaritur me 20% vlere te mbetur.

Bashkangjitur eshte lista e detajuar per "Aktivet Afatgjata materiale" me sasite, çmimin e blerjes, amortizimin deri ne 31.12.2019 dhe me vleren e mbetur deri me 31.12.2019.

Bashkangjitur eshte edhe lista e detajuar per "Aktivet Afatgjata materiale" me vlefte fillestare me 01.01.2019, me shtesat dhe pakesimet per vitin 2019 dhe me gjendjen ne vlefte fillestare me 31.12.2019.

5. Detyrime afatgjata – Huate Afatgjata

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 paraqiten si me poshte:

Nr	PASIVET DHE KAPITALI	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
II	PASIVET AFATGJATA	188.157.577	228.159.577

Adresa: Rruga e Kavajes, Ish parku i Autobuzave, Kullat Condor, Kulla "C" Kati 3, Tirane.

Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 069 20 32 353, 068 20 45 054

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com



1	Huat afatgjata	188.157.577	228.159.577
	> <i>Hua,bono dhe detyrime nga qeraja financiare</i>	188.157.577	228.159.577
	> <i>Bono te konvertueshme</i>		

Kjo shume eshte kredite e marra gjate vitit 2019 dhe me perpara dhe te cilat jane pa likujduar deri me daten 31.12.2019.

Per keto kredi shoqeria disponon te gjithë procedurat e marrjes se tyre ne institucionet bankare, tek Raiffaisen banke dhe tek BKT-ja

6.. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Nr	PASIVET DHE KAPITALI	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
3	Huat dhe parapagimet	1.419.722.838	1.562.876.557
	> <i>Te pagueshme ndaj furnitoreve</i>	1.386.759.487	1.532.371.991
	> <i>Te pagueshme ndaj punonjesve</i>	12.306.528	21.597.616
	> <i>Detyrime per Sigurime Shoq.Shend. dhe TAP</i>	3.379.470	2.700.509
	> <i>Detyrime tatimore per Tatim Fitimin</i>	3.623.466	0
	> <i>Detyrime tatimore per Tvsh-ne</i>	7.983.533	2.700.509
	> <i>Detyrime tatimore per Renten Minerare</i>	61.938	65.582
	> <i>Detyrime tatimore per tatimin ne burim</i>	35.250	35.250
	> <i>Dividente per tu paguar</i>	0	
	> <i>Debitore dhe Kreditore te tjere</i>	0	
	> <i>Parapagime dhe porosi</i>	0	

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2019 paraqiten si vijon:

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e materialeve e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit . Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per çdo furnitor.

Organet drejtuese te shoqerise mendojne se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

Bashkangjitur eshte edhe lista e detajuar per “Te pagueshme ndaj furnitoreve” me emertimet perkatese dhe shumat perkatese deri me 31.12.2019.

“Te pagueshme ndaj punonjesve” ne shumen 12.306.528 leke perfaqeson pagat te cilat nuk jane paguar por qe do te paguhen ne vitin 2020.

“Detyrimet tatimore per sig.shoqerore“ , paguhen ne muajin Janar 2020.

“Detyrime tatimore per TVSH-ne” eshte detyrim i TVSH-se per muajin dhjetor 2019 e cila paguhet ne muajin Janar 2020.



“Detyrime tatimore per tatim fitimin” eshte Tatim fitimi i detyrueshem per tu paguar deri ne dt 31.03.2020

7. Kapitali e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2019 ai eshte 493.000.000 leke, i ndare ne 493,000 kuota me vlere nominale 1000 leke /kuota. Gjate ushtrimit kontabel 2019 Kapitali ka ndryshuar eshte shtuar me 88.000.000 leke sipas vendimit ortakut te vetem **nr 8, date 30/06/2019**

Rezervat ligjore ne shumen 6.807.714 leke, per vitin ushtrimor 2019 eshte shtuar. Kjo shume eshte pasqyruar edhe ne vendimet e depozituara dhe te miratuara ne QKR.

8. Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ Te ardhurat

Të ardhurat nga shitja e punimeve dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme te zhveshura nga TVSH-ja.

Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore


Konsumi i materialeve, furniturave dhe sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumat e paguara ose te pagueshme. Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2019 jane treguar ne pasqyren perkatese.

▪ Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

▪ Shpenzime personeli

Shoqeria ka marre ne pune dhe ka paguar punonjesit e saj konform dispozitave ligjore. Per ata jane paguar kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore dhe jane ber ndalesat per keto kontribute si dhe per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi rregullisht.



Fitimi i ushtrimit dhe tatimi mbi fitimin

Te ardhurat dhe shpenzimet per llogaritjen e tatimit mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2019 jane si vijon:

Te ardhura nga periudha te meparshme jane furnitore te palikuiduar nder vite (ne pasiv)

Llog.	Pershkrim	Shpenzime
TE ARDHURA		
701	Shitje e produkteve te gatshem	16.728.427
704	Shitje e punimeve dhe e sherbimeve	1.121.266.432
714	Shitje Materiale furnitura	980.000
TOTALI		1.138.974.859
Te ardhura nga ndryshimi i kursit te kembimit		1.717.872
Te ardhura te periudhave te meparshme		230.217.879
Shuma totale e te ardhuarve		1.370.910.610
SHPENZIME		
6010	Blerje le nde te para dhe materiale te para	494.256.542
6011	Blerje karburant,solar, L. djegese.	234.485.576
6040	Blerje energji elektrike	3.467.380
604	Blerje uje avull	787.612
613	Qera	540.000
	Blerje / shpenzime mallra dhe sherbime	4.119.662
6110	Situac. punim. dhe sherbime nga te trete	57.658.118
6118	Nentrajtme dhe sherbime te tjera	2.799.745
6151	Mirmb. e riparime per mjetet e transp.	89.589.333
6160	Prime te sig per AQ te trup, (jo mjete transporti)	3.287.008
6162	Prime te sigurimit per mjetet e transportit	3.808.742
6168	Shpenzime projektimi	15.000.000
6182	Shpenzime blerje kancelari	824.216
62110	Shpenzime gjyqesore, avokatie, noteri perkthime	2.273.700
62112	Shpenzime konsulence fiskale, financiare	630.000
625	Transferime, udhetime dhe dieta	14.016.582
6262	Shpenzime telefoni mobile	1.098.579
6263	Shpenzime internet	98.225
6271	Transport per blerje	2.741.181
634	Taksa dhe tarifa vendore	1.681.972
635	Taksa e rregjistrimit	2.541.576
6381	Akcize per plastiken	19.700.248
641	Paga dhe shperblime per punonjesit	107.314.389

Adresa: Rruga e Kavajes, Ish parku i Autobuzave, Kullat Condor, Kulla "C" Kati 3, Tirane.

Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 069 20 32 353, 068 20 45 054

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com



644	Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	16.826.435
659	Sponsorizime	2.525.190
66101	Interesa nga BKT	5.667.089
660	Komisione bankare	1.045.269
6811	Amortizimi	127.921.374
Shuma e shpenzimeve		
I	FITIMI NETO PARA TATIMIT	154.204.867
II	SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	0
		0
III	Fitimi (Humbja) tatimore	154.204.867
IV	Shpenzimi i tatimit mbi fitimin 15%	23.130.730
V	Fitimi neto i ushtrimit (2019)	131.074.137

Tatim fitimi i ushtrimit eshte i llogaritur mbi fitimin e tatushem i cili ka dale pasi i jane shtuar fitimit te ushtrimit edhe shpenzimet e pazbriteshme ne shumen 131.074.137 leke

9. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit

Asnje ngjarje e rendesishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit te pasqyrave financiare.

11 Shifrat krahasuese

Shifrat krahasuese te deklaruar ne pasqyrat financiare 2019 jane te krahasueshme me ato te pasqyrave te ushtrimit 2019 pasi jane ndertuar sipas SNK-ve dhe ligjit Nr.9228 dt 29.04.2004 qe u aplikuan per here te para ne ushtrimin e mbyllur me 31.12.2019.

Tirane me 09.03.2019

Per shoqerine ANK Shpk.

Administratori

Agim KOLA



Adresa: Rruga e Kavajes, Ish parku i Autobuzave, Kullat Condor, Kulla "C" Kati 3, Tirane.

Tel +355 4 2247 931, Tel/fax +355 4 2269 543, Cel: 069 20 32 353, 068 20 45 054

Mail: sekretariaankshpk@yahoo.com dhe financaankshpk@yahoo.com